

AKT THEMELIMI

Sot ne dt.09 Gusht 2021 me cilesine e " Ortakeve Themelues ",

Renata Rybicka, e bija e Andrzej e datelindjes 17/03/1987, e lindur ne Plock, Poloni dhe banuese ne adresen Ciesle 47,09-470 Bodzanow,Poloni shtetase polake, madhore me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr. DBV211401.

Lukasz Rybicki, i biri i Karol i datelindjes 24/04/1983, i lindur ne Plock,Poloni dhe banues ne adresen Ciesle 47,09-470 Bodzanow,Poloni shtetas polak, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.AVW537936,

te cilet me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin " Per QKR", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin **URBE** shpk.

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja,Objekti

Neni 1

Emertimi

Emertimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **URBE** shpk. Shoqeria do të nenshtrohet legjislacionit Shqiptar.Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria **URBE** shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **URBE** shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaket që përballojne humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne adresen:

Sarande,Rr.Bilal Golemi,zk 8642,pasuria nr.15/522+1-19,kati i katert.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

- Shitje dhe blerje,dhenie me qera,administrim te pasurive te paluajtshme si ndertesa,toka,troje dhe objekte industriale.
- Ndertim te objekteve civile,industriale,bujqesore, turistike dhe ekonomike, rikonstruksione objektesh,ndertim sillosa,kulla uji,rruge,ura,vepra arti, ndertim ujesjellesa,kanalizime,kanale e impjante vaditje,ndertim digash punime karpentjenerie prej druri dhe metalike,perforcime themeli dhe izolime mbi dhe nentokesore,bojatisje,hidroizolim,punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge,ndertim mbishtresash rrugore.
- Importin , eksportin dhe tregetin me shumice dhe pakice te

Rybić

M

artikujve te ndryshem industriale , ushqimore , produkteve te ndryshme bujqesore , blegtorale e fruta perime , prodhimeve te detit , pije freskuese , te miellit e nenprodukteve te tij , te konfeksioneve e veshmbathjeve , pajisje elektroshtepiake , kompjutera dhe pjeset e tjera te tyre , produkte higjenosanitare , hidraulike , prodhime qeramike artizanati, duralumini , mekanike te lendes drusore te perpunuar dhe te paperpunuar, lekures e nenprodukteve te saj , mobiljeve dhe materialeve te lendeve te para te te gjitha llojeve , materiale dhe lendeve te ndertimit , pllakat e llojeve dhe dimensioneve te ndryshme , materialeve plastike e nenprodukteve te tyre.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1.200.000 lekë.

Kapitali i shoqerise eshte 1.200.000 leke i perbere nga 2 kuota dhe zoterohet nga ortakët e shoqerise si me poshte :

1. Ortaku Themelues: **Renata Rybicka**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 588.000 Leke, e cila perfaqeson 49 % te kapitalit te shoqerise,
2. Ortaku Themelues: **Lukasz Rybicki**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 612.000 Leke, e cila perfaqeson 51 % te kapitalit te shoqerise.

Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar **1.200.000 Leke**

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortakët pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te tretteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Asamblese se ortakeve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e ortakeve brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 9

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga **Renata Rybicka**, e bija e Andrzej e datelindjes 17/03/1987, e lindur ne Plock, Poloni dhe banuese ne adresen Ciesle 47,09-470 Bodzanow, Poloni shtetase polake, madhore me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr. DBV211401.

Rybicka

[Signature]

Emerimi i administratorit është me një afat pese vjeçar me të drejte riemerimi, i cili ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet e themelimit të shoqërisë të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblese së ortakut të vetëm të shoqërisë.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asamblese së ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratori ose ortakët që nuk janë persona juridikë nuk u lejohej të kontraktojnë në çfarëdo formë qoftë, të marrin hua të shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzues apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.
Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar siç mund të jehet

a. Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimtë të metejshme të veprimtarisë së saj.

b. Në një nga menyrat e parashikuara nga ligji "Për Falimentimin"

c. Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Në këto rast Asambleja e ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon menyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil, Ligji për QKB, dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15

Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në katër ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nënper nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare **URBE** shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

Ilirija Ruzhica *Dylchira Ruzhica*
Ruzhica *DR*